
NJOFTIM PËR PUNË PRAKTIKE PËR STUDENTËT E FAKULTETEVE JURIDIKE – 8 POZITA

Organizata jo-qeveritare “National Center for State Courts (NCSC)” ofron mundësi për punë praktike me pagesë për 8 studentë apo te diplomuar të fakulteteve juridike të akredituara në Kosovë, nga një student për secilin nga rajonet: Prishtinës (2 studentë), Prizrenit, Mitrovicës, Pejës, Gjakovës Ferizajit dhe Gjilanit. Mundësia për punë praktike është e hapur në kuadër të Programit “Drejtësia vlen” dhe puna realizohet në zyret e Agjencisë për Ndhimën Juridike Falas (ANJF). Kohëzgjatja e punës është gjashtë (6) muaj, me mundësi vazhdimi.

Mbi Programin Drejtësia Vlen

Drejtësia vlen është një program tre vjeçar për çasjen në drejtësi, i financuar nga Agjencia e SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe menaxhohet nga National Center for State Courts (NCSC) për të përmirësuar çasjen në drejtësi për të gjithë, përfshirë grupet e pafavorizuara dhe të marginalizuara, duke forcuar sistemet dhe shërbimet për ndihmë juridike falas dhe ofrimin e informative mbi ndihmën juridike falas.

Studentët e përzgjedhur do të mbështesin zyret rajonale dhe zyrën qendrore të ANJF-së në kryerjen e punëve profesionale dhe administrative. Përgjegjësitë e praktikantëve do të përfshijnë asistimin e stafit të ANJF në intervistimin e palëve dhe vendosjen e të dhënave të palëve në databazë, përpilimin e shkresave dhe kryerjen e punëve të tjera administrative. Përveç kësaj, studentët e përzgjedhur do të ndihmojnë stafin e programit për të planifikuar ngjarje (p.sh. punëtori, takime informuese me qytetarët) në kuadër të programit.

Kandidatët duhet të kenë:

- Shkathësi të intervistimit të palëve;
- Shkathësi të këshillimit ligjor;
- Shkathtësi të mira në hulumtim dhe shkrim ligjor dhe vëmendje në detaje;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe si pjesë e një ekipi;
- Aftësi në komunikim me publikun;
- Fleksibilitet për punë në teren;
- Njohuri të avancuara të gjuhës angleze dhe zotërim të mirë të njërës nga gjuhët zyrtare të Kosovës.
- Preferohen aplikacionet nga studentët e vitit të katërt, të diplomuar ose student të programit master.

Dokumentet e kërkuara

Studentët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim në emailin info@ncsc-ks.org:

- CV-ja;
- Letër motivuese në të cilën shprehet mendimi juaj se pse është e rëndësishme drejtësia për ju;
- Çertifikata e notave dhe ndonjë çertifikatë të punës praktike të mëhershme, apo ndonjë reference.

Për të aplikuar dërgoni me email dokumentet e kërkuara në adresën e e-mailit me subjektin “NCSC Justice Matters Internship” deri më **28 Shtator 2018**. Për shkak të numrit të madh të kandidatëve, vetëm kandidatët në listën e ngushtë do të kontaktohen. Asnjë telefonatë nuk pranohet lidhur me këtë përzgjedhje dhe çfarëdo përpjekje për të kontaktuar NCSC apo USAID do të rezultojë në diskualifikim të menjëhershëm.